



Republika e Kosovës * Republic of Kosova

Komuna * Municipality

Hani i Elezit



DATE: 16.07.2025

NR.09/5375/2025

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës ¹: 659-25-4942-5-5-8/C654 & KKHE-25-016-5-5-8

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË, GRACANICA, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

MINITENDER - Furnizim me pajisje të IT-se - sipas LOT-eve me numër identifikues: 659-25-4942-5-5-8

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Llot.-II-
2	MINITENDER - Furnizim me pajisje të IT-se per financa

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë jo më vonë se 15 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues. Kohëzgjatja e kontratës është me afat prej 1 muaj apo 30 dite nga nënshkrimi i saj mes palëve-

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Komuna Hani i Elezit.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 2,110.00 €; [Dymijë e njëqindë e dhjetë Euro] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet


6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	16.07.2025
Vula:	

Për Furnizuesin ARITECH

Emri:	Belina Mufiri
Pozita:	Mënyëgjatë Shitje
Nënshkrimi:	
Data:	16.07.2025
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-25-4942-5-5-8/C654: KKHE-25-016-5-5-8

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	9.1	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës në 10% e vlerës së kontratës me afat prej 60 diteve apo dy muaj
Sigurimi	10.1	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës në 10% e vlerës së kontratës me afat prej 60 diteve apo dy muaj
Programi i ekzekutimit	11	Kohëzgjatja e kontratës është 30 dite apo 1 muaj nga nënshkrimi i saj kurse furnizimi duhet të realizohet jo më shumë se 15 dite nga kërkesa që AK- Komuna Hani i Elezit i drejtohet OE-se në fjalë, ashtu siq është percaktuar në dosje të tenderit.
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Te gjitha taksat e aplikueshme duhet të kalkulohen në çmime
Patentat dhe licencat	13.1	[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]
Vonesat në ekzekutim		Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
Cilësia e furnizimeve	18.2	Laptopet dhe paisjet tjera duhet të jenë konform kërkesave të dosje se tenderit –dhe specifikave të percaktuara tek marrëveshja publike kornize
Inspektimi dhe testimi	19.2	Furnizimi do të kontrollohet për cilësi dhe sasi dhe me pas do të pranohet nga AK –nese është konform kushteve të kontratës –sipas obligimeve
Menaxheri i kontratës	19.3	Menaxheri i kontratës do të cakohet me vendim të ZKA-së
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet pas realizimit të furnizimit të percaktuar tek lista e artikujve. Pagesa do të bëhet brenda afatit ligjor pas pranimit të furnizimit i pranuar nga AK
Dorëzimi	21.3	Furnizimi artikujt duhet të jenë të reja , të bëhet konform listës që janë percaktuar tek lista e artikujve ku furnizimi në paketime adekuate.
Obligimet e garancionit	24.1	3 vite apo 36 muaj nga koha e pranimit të laptopve dhe paisjeve tjera nga AK-Komuna Hani i Elezit
	24.5	3 vite apo 36 muaj nga koha e pranimit të laptopve dhe paisjeve tjera nga AK-Komuna Hani i Elezit
Shërbimet pas shitjes	25.1	3 vite apo 36 muaj nga koha e pranimit të laptopve dhe paisjeve tjera nga AK-Komuna Hani i Elezit
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit të Elezit ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Komercele –Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].